PSH.nr.865/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina – Referues, Goran Milenkovic – Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik Ndërmarrja Tregtare Grafike "Blendi"-Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shtypja e botimeve të ASHAK-ut", me nr. të prokurimit: 231-20-6246-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës /ASHAK/, më datën: 23.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: Ndërmarrja Tregtare Grafike "Blendi"-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: : "Shtypja e botimeve të ASHAK-ut", me nr. të prokurimit: 231-20-6246-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës /ASHAK/.

II. **i LEJOHET**, autoritetit kontraktues - Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit por, nëse është nevoja (nëse ka skaduar afati i dorëzimit te ofertave) të beje zgjatjen e afatit për dorëzimin e ofertave konform dispozitave të LPP-së lidhur me aktivitetin të prokurimit: "Shtypja e botimeve të ASHAK-ut", me nr. të prokurimit: 231-20-6246-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës /ASHAK/.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues Ndërmarrja Tregtare Grafike "Blendi"-Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues Ndërmarrja Tregtare Grafike "Blendi"-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 29.10.2020 me nr. 865/20, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shtypja e botimeve të ASHAK-ut", me nr. të prokurimit: 231-20-6246-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës /ASHAK/, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 30.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 09.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimit ankimor të OE ankues lidhur me zgjatjen e afatit për dorëzimin e tenderëve, sqaron se OE ka bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me datë 23.10.2020, duke kërkuar substancat e letrës pasi kjo letër është specifike. AK në përgjigje të kërkesës për rishqyrtim, më datë 27.10.2020 i dërgon substancat e letrës vetëm dy ditë para hapjes së tenderit, por nuk e shtyn afatin për dorëzimin e tenderit me arsyetimin se është fundi i vitit kalendarik. Lidhur me këtë pretendim, eksperti shqyrtues sqaron se duke pasur parasysh që AK me datë 27.10.2020 i ka dërguar OE ankues substancën e letrës dhe dërgimi i substancës së letrës është bërë 3 ditë para mbylljes së afatit për dorëzimin e tenderëve (30.10.2020), atëherë në këto rrethana është paraparë sipas nenit 53, par. 7 të LPP-së, që të zgjatet afati për dorëzimin e tenderëve edhe për dhjetë (10) ditë. Kjo dispozitë ligjore përcakton se kur autoriteti kontraktues u jep informata sqaruese ose plotësuese operatorëve ekonomik, dhe afati në të cilin informatat e tilla jepen është më i shkurtë se dhjetë (10) ditë nga afati i caktuar për pranimin e tenderëve, autoritetit kontraktues do ti zgjatet afati i tillë për ti dhënë operatorëve ekonomik së paku dhjetë (10) ditë nga dita në të cilën informatat përkatëse jepen për ti dorëzuar

tenderët e tyre. Pra, për mendimin e ekspertit shqyrtues, dorëzimi substancës së letrës nënkupton sqarim të tenderit siç është përcaktuar në nenin 53 par. 7 të LPP-së. Gjithashtu, edhe kërkesa e OE ankues është e arsyeshme duke pasur parasysh faktin që në tregun tonë nuk ka asortiment të gjerë të produkteve të ndryshme dhe pothuajse shumica e produkteve varen nga importi. Për më tepër, AK gjatë zhvillimit të ndonjë aktiviteti të prokurimit duhet të sigurohet që të zgjerohet konkurrenca dhe jo të ngushtohet, ku përmes konkurrencës mund të arrihet edhe qëllimi sipas nenit 1 të LPP-së, si dhe ekonomiciteti dhe efikasiteti sipas nenit 6 të LPP-së. Andaj, eksperti konsideron se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e cekura në raport, Eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Më tej propozohet që të obligohet AK të bëj zgjatjen e afatit për dorëzimin e ofertave konform dispozitave të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues, më datë: 10.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 10.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 16.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me zgjatjen e afatit për dorëzimin e tenderëve, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ka bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me datë 23.10.2020, duke kërkuar substancat e letrës pasi kjo letër është specifike. AK në përgjigje të kërkesës për rishqyrtim, më datë 27.10.2020 i dërgon substancat e letrës vetëm dy ditë para hapjes së tenderit, por nuk e shtyn afatin për dorëzimin e tenderit me arsyetimin se është fundi i vitit kalendarik. Lidhur me këtë pretendim, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se duke pasur parasysh që AK me datë 27.10.2020 i ka dërguar OE ankues substancën e letrës dhe dërgimi i substancës së letrës është bërë 3 ditë para mbylljes së afatit për dorëzimin e tenderëve (30.10.2020), atëherë në këto rrethana është paraparë sipas nenit 53, par. 7 të LPP-së, që të zgjatet afati për dorëzimin e tenderëve edhe për dhjetë (10) ditë. Kjo dispozitë ligjore përcakton se kur autoriteti kontraktues u jep informata sqaruese ose plotësuese operatorëve ekonomik, dhe afati në të cilin informatat e tilla jepen është më i shkurtë se dhjetë (10) ditë nga afati i caktuar për pranimin e tenderëve,

autoritetit kontraktues do ti zgjatet afati i tillë për ti dhënë operatorëve ekonomik së paku dhjetë (10) ditë nga dita në të cilën informatat përkatëse jepen për ti dorëzuar tenderët e tyre. Pra, për mendimin e ekspertit shqyrtues, dorëzimi substancës së letrës nënkupton sqarim të tenderit siç është përcaktuar në nenin 53 par. 7 të LPP-së. Gjithashtu, edhe kërkesa e OE ankues është e arsyeshme duke pasur parasysh faktin që në tregun tonë nuk ka asortiment të gjerë të produkteve të ndryshme dhe pothuajse shumica e produkteve varen nga importi. Për më tepër, AK gjatë zhvillimit të ndonjë aktiviteti të prokurimit duhet të sigurohet që të zgjerohet konkurrenca dhe jo të ngushtohet, ku përmes konkurrencës mund të arrihet edhe qëllimi sipas nenit 1 të LPP-së, si dhe ekonomiciteti dhe efikasiteti sipas nenit 6 të LPP-së. Andaj, ky pretendim ankimor është i bazuar.

Megjithatë, duke pasur parasysh që OE ankues ka parashtruar ankesë me datë 29.10.2020 pranë OSHP-së, dhe tani më ka kaluar pothuajse një muaj nga parashtrimi i ankesës, kurse OE ankues ka kërkuar që të zgjatet afati për dhjetë ditë, ndërsa në anën tjetër AK arsyetohet se zgjatja e afatit do të ndikonte për shkak të fundit të vitit kalendarik dhe këto produkte lidhin me fundin e vitit, atëherë Paneli Shqyrtues konsideron se ankesa e OE ankues është e bazuar dhe kërkesa për zgjatje të afatit prej 10 ditësh tani më është arritur, në këto rrethana i lejohet AK-së që të vazhdoj me këtë aktivitet të prokurimit dhe ti lejohet OE ankues me dorëzimin e tenderit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK ASHAK;

1x1 OE Ndërmarrja Tregtare Grafike "Blendi"-Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.